



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 3030/12 prot.

Datë 06/02/2024

**V E N D I M**  
**Nr. 140/2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06/02/2024, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 95/2024, datë 26.01.2024 për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-79764-09-13-2023, me objekt “Blerje pajisje mobileri për shkollat e arsimit bazë (Shkolla 9-vjeçare “Adem Sheme dhe shkolla “9 Tetori”, Sarandë”, me fond limit 14,725,434 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 13.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Sarandë.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “ERALD” SHPK me NIPT: J74517205P dhe adresë: *Rruga Nacionale Tiranë Fushë Krujë, km. 132, ndërtesë private 1 katëshe, zona kadastrale 3096, me nr. pasurie 97/30, Durrës Nikël Qereke, Durrës.*

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Sarandë  
*Adresa: Rruga “Abedin Dino”, Lagja Nr. 1, Sarandë.*

**Subjekte të Interesuar:** Operatori ekonomik “Klame” SHPK me NIPT: K21518003F dhe adresë: *Njësia Administrative 11, Kodër Kamëz, Rruga “Gani Kryeziu”, Nr. 23, Kati I, Tiranë.*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i

Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

### **Vëren:**

#### **I**

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 26.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 95/2024, ku vendosi:

1. Të pranohet ankesën e operatorit ekonomik “ERALD” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-79764-09-13-2023, me objekt “Blerje pajisje mobileri për shkollat e arsimit bazë (Shkolla 9-vjeçare “Adem Sheme dhe shkolla “9 Tetori”, Sarandë”, me fond limit 14,725,434 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 13.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Sarandë.
2. Autoriteti kontraktor të anulohet vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomikë “KLAME” SHPK, dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operatorë ekonomikë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ERALD” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me anë të shkresës nr. 527/1 prot., datë 02.02.2024, të protokolluar me tonën me nr. 3030/9 prot., datë 05.02.2024, autoriteti kontraktor Bashkia Sarandë njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 95/2024, datë 26.01.2024 të Komisionit të prokurimit Publik, për procedurën e

prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-79764-09-13-2023, me objekt “Blerje pajisje mobileri për shkollat e arsimit bazë (Shkolla 9-vjeçare “Adem Sheme dhe shkolla “9 Tetori”, Sarandë”, me fond limit 14,725,434 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 13.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Sarandë.

## II

### Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### Arsyeton

II.1. Me anë të shkresës nr. 527/1 prot., datë 02.02.2024, të protokolluar me tonën me nr. 3030/9 prot., datë 05.02.2024, autoriteti kontraktor Bashkia Sarandë njofton se ka zbatuar vendimin Nr. 95/2024, datë 26.01.2024 të Komisionit të prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-79764-09-13-2023, me objekt “Blerje pajisje mobileri për shkollat e arsimit bazë (Shkolla 9-vjeçare “Adem Sheme dhe shkolla “9 Tetori”, Sarandë”, me fond limit 14,725,434 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 13.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Sarandë.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se, autoriteti kontraktor ka skualifikuar operatorin ekonomik “KLAME” SHPK, në përputhje me vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 95/2024, datë 26.01.2024.

II.2. Sa më sipër, autoriteti kontraktor Bashkia Sarandë ka zbatuar vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 95/2024, datë 26.01.2024, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenit 46 pika 2 e Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-79764-09-13-2023, me objekt “Blerje pajisje mobileri për shkollat e arsimit bazë (Shkolla 9-vjeçare “Adem Sheme dhe shkolla “9

*Tetori”, Sarandë”, me fond limit 14,725,434 Lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 13.10.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Sarandë.*

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

